

ASYL IN DEUTSCHLAND – Die Anhörung – albanisch

Azil ne Gjermani? Intervista.

Ti je larguar nga vendi yt per te shpetuar nga lufta, ndjekja apo diskriminimi. Ketu ne Gjermani ti mund te besh kerkesen per shqyrtim e te drejtes se azilit tend. Ministria e emigracionit (e ashtequjitur BAMF) shqyrton ne nje kohe relativisht te shkurter shkaqet, qe te kane cuar ty te lesh vendin tend dhe merr vendimin.

Nga ministria e emigracionit te caktohet nje orare takimi per intervisten, ku ti para zyrtareve te ministrise dhe me ndihmen e nje perkthyesi, ke mundesi te tregosh dhe nje here historine dhe shkakun e largimit nga vendi yt. Kjo interviste eshte shume e rendesishme per ty, pasi pas saj, zyrtari i ministrise merr vendim, se a i ploteson te gjitha kushtet per te marre statusin e azilantit, apo jo!

Ne interviste ti do pershkruash vendin tend dhe gjendjen aktuale atje. Ti duhet ti bindesh se pse ishe i detyruar ta lesh vendin tend dhe ç'fare te rrezikon nese duhet te kthehesht atje. Vetem neqoftese Ti arrin te pasqyrosh dhe te na bindesh me arsyet e tua, pse ti nuk ishe me i sigurte prej luftes ne vendin tend, apo prej ndjekjes apo persekutimit, vetem atehere Ty mund te jipet azili i kerkuar.

Cilat mund te jene arsyet e largimit tend?

Ndjekja nenkupton, qe shteti yt, TY si individ, nuk eshte ne gjendje te te mbroje nga grupe qe te ndjekin TY, por ndoshta te ndjek edhe vet shteti yt ty, apo edhe familja jote te ndjek. Dhe arsyet e perndjekjeve mund te jene te natyrave te ndryshme si per shembull: Ne rast se TI je pjese i nje grupi minoren (roma), per arsyen besimi fetar, per aktivitete politike apo per orientim seksual nuk gje akceptance ne vendin tend dhe nuk je mbi te gjitha i toleruar.

Deri sa te te caktohet data e intervistes mund te zgjase disa kohe. Mundohu ta shfrytezosh kete kohe per te rikonstruktuar edhe nje here se ç'fare dhe si kane ndodhur ngjarjet e tua, ndoshta do te doje ti shruaje ato, apo tja tregoje dikujt per ti pervesuar ndodhit e tua keshtu edhe me mire.

Ç`do person i rritur merret individualisht ne pyetje. Eshte normale, qe ngjarjet dhe ndodhit e tua mund te jene te gjata dhe te komplikuara. Por ti ke te drejten tende ti tregosh ato sakte dhe gjate, sic i ke perjetuar, te gjitha per cfar ti mendon se jane te rendesishme,. Merr kohen e duhur qe te duhet. Ne interviste ke mundesine te tregosh me qetesë çdo gje qe te ka ndodhur. Neqoftese nuk mban mend saktesisht ndonj gje apo nuk je i sigurt ne detaje te percaktuara, eshte shume e rendesishme ta thuash kete dhe jo te sajosh gjera te paqena. Sepse keto te gjitha influencojne me vone per vendosjen e asilit tend.

Gjate intervistes, do t'ju behen shume pyetje, por ti mos u huto dhe mos u ngaterro me fjalet e tua. Te rekomandohet, qe te maresh me pare keshilla ne nje nga stacionet konsultuese per refugjatet, apo edhe tek ndonje avokat i specializuar ne kete fushe.

Per intervisten merr patjeter me vete çdo dokument, si: fotot, video, email, letra, dokumente, vertetime mjekesore, paketimet e ilaceve, artikuj gazetash ndoshta,

deklarata apo postime neper rrjetet sociale sie Facebook-Postime, etj. apo edhe thenie te ndonje deshmitari, e te tjera te ketre natyrave. Neqoftese ti mendon, qe ke edhe fakte te tjera, qe mund ti perdonje, por qe akoma nuk munde ti zoteroje deri ne diten e intervistes, thuaje kete menjehere, qe ti do tju a paraqesesh me vone.

Instuticioni per kerkes-asili (BAMF) do tju vere per intervisten nje perkthyes ne dispozicion!

Gjate intervistet lejohet te perkthehet vetem ato qe do te thuash dhe tregosh Ti. Neqoftese Ti nuk e kupton mire perkthyesin, apo nuk ke besim tek ai, thuaje kete menjehere sa po ta ndjesh gjate intervistes, edhe pse ti ndoshta e ke te veshtire. Madje, ty te lejohet te sjellesh nje perkthyes nga ana e jote, gjithashtu mund te marresh edhe nje person shoquerues. Neqoftese per TY ka rendesi gjinia e perkthyesit, pra deshiron te jete per shembull femer apo mashkull, mund ta shprehesh deshiren, por vetem se per kete deshire dhe te gjitha te tjerat te lartpermendura, duhet te besh nje kerkesa me pare me shkrim tek instutacionet per kerkim-asil.

Intervista eshte teper sekrete. Gjithshka cfar ti do te thuash, nuk del nga dhoma.

Normal eshte, qe ndoshta e ke te veshtire te flasesh per gjerat qe ti ke perjetuar. Te lutem mos u ngut, ke te drejten te besh edhe pushime ose madje ne rast se nuk mundesh me, ta shtysh intervisten per nje dite tjeter.

Cdo gje qe TI tregon protokollohet. Ti e ke te drejten te kerkosh, qe protokoli te perkthehet ne gjuhen tende per te pasur mundesine te verifikosh, nese eshte protokolluar ashtu sic dhe ti je shprehur apo jo. Ndoshta do te doje te beje edhe ndonje korigjim.

Ne fund protokolli firmoset, vetem nese Ti je i bindur per perpilimin e sakte te intervistes sipas thenieve te tua.

Protokollimi i intervistes, do te dergohet TY brenda javeve te ardhshme me post, po qe se jo, atehere, duhet te leshe te konsultohesh.

Pas disa kohesh te dhenies se intervistes, te vjen me post vendimi i ministrise mbi kerkesen tende per asyl. Kjo leter e ministrise eshte shume e rendesishme dhe prandaj, ministria duhet te jete e informuar gjithmon per adresen tende aktuale.

Nese TY te njihet statusi i azilkerkuesit, perfiton lejen e qendrimit ne Gjermani. Nese ky status ty nuk te njihet, Ti ke mundesine te kundershtosh me gjyq. Per proceduren e ankeses ke shume pak kohe, nga dita qe te kane dorezuar letren postare. Prandaj ruaje zarfin me vendimin nga ministria se aty eshte vula me daten qe ke marre letren. Me ate leter drejtohu direkt ne nje zyre konsultative ose te nje avokati.

Gjate gjithe procedures ne lidhje me kerkesen per azil, ke te drejte per konsulte dhe te drejte qe kerkesa jote te shqyrtohet. Ceshta e azilit eshte e komplikuar, prandaj kurdo qe te keshe pyetje, ti duhet te kerkosh ndihme dhe keshille. Ketu ti do te gjeshe disa instutacione perkatese si pika pritjeje.

